



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVA**

**Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
Office of The Auditor General
Kancelarija Generalnog Revizora**

Nr. dok. 21.8.1-2008-08

**RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE TË
MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE POST-
TELEKOMUNIKACIONIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETOR 2008**

Prishtinë, 28 Korrik 2009

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja lidhur me rekomandimet nga viti i kaluar
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V Qasja e auditimit
- VI. Opinioni i auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II Komentet e MTPT-se dhe vlerësimet e ZAP-it

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
ILA	Institucionet e Larta të Auditimit
INTOSAI	Organizatat Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare Institucioneve Supreme të Auditimit
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit
OE	Operatori Ekonomik
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së transportit dhe post-telekomunikacionit (MTPT) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008.

Auditimi ynë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne i vlerësuam si të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Për mendimin tonë, pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Si theksim i çështjeve ne dëshirojmë që t'iu tërhekim vëmendjen lidhur me:

Pasuritë fikse nuk janë shpalosur në pasqyra financiare.
(ISSAI 400 *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

Auditimi ynë ka shpalosur disa dobësi që kanë të bëjnë me ekzekutimin e buxhetit dhe sistemin e kontrollit të brendshëm.

1. Inventarizimi jo i plote i pasurisë nga ana e komisionit përgjegjës dhe mos azhurnimi i të dhënave për pasurinë.
2. Blerja e programit për regjistrimin e pasurisë dhe mos futja e të dhënave ,flet për një neglizhencë dhe mos shfrytëzimin e resurseve në mënyrë adekuate.
3. Mos inkasimit i të hyrave për kyçjet në rrugë dhe kyçjet ilegale në brezin rrugor, mungesa e mbikëqyrjes në mbledhjen e të hyrave nga njësia e patentë-shofereve, shkakton humbje domethënëse buxhetit të MTPT;
4. Mungesa e planit përfundimtar të prokurimit, vlerësimi preliminar dhe përfundimtar i ofertuesve në kundërshtim me kriteret e përcaktuara, emërimi i personave të njëjtë në komisionet e vlerësimit të ofertave, mos kryerja e auditimeve në prokurim ,flasim për kontrolle të brendshme të pa mjaftueshme në menaxhimin e procesit të prokurimit;
5. Mos mirëmbajtja e softuerit të kontabilitetit për regjistrimin e shpenzimeve të MTPT për një kohë të gjatë mund të ndikojë në saktësinë e regjistrimeve kontabël.

Rekomandimi ynë kryesor për Ministrin është që të forcoj kontrollet e brendshme, sidomos në eliminimin e dobësive të identifikuar më lart.

II. HYRJE

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është sipas ligjit përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që mirren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtruar auditimit dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin;

Është përgjegjësi e Ministrisë së transportit dhe post-telekomunikacionit (MTPT) të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2008/13, dhe ato ti prezantoj me kohë.

III. GJENDJA E REKOMANDIMEVE NGA VITI I KALUAR

Auditimi i ZAP mbi pasqyrat financiare të MTPT për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2007 kishte rezultuar me 12 rekomandime në katër fusha të ndryshme. Prej këtyre rekomandimeve, katër nuk janë adresuar:

- Blerjen e programit të ri për regjistrimin e transaksioneve financiare;
- Përditësimin e të dhënave të regjistrit kontabël të pasurisë;
- Nxjerrjen e procedurave të shkruara për mbledhjen e borxheve të papaguara nga të hyrat për kyçe në rrugë dhe
- Për formimin e komisionit , i cili do të regjistronte të gjitha bizneset që i shfrytëzojnë të gjitha rrugët publike.

Dështimi i menaxhmentit të MTPT-së në implementimin e plotë të rekomandimeve tona ka shkaktuar përsëritjen e dobësive të njëjta sikur viteve të kaluara. Mungesa e masave të

vendosura nga Menaxhmenti mbi të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit janë një arsye për shqetësim.

IV. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

Ky auditim i MTPT ka të bëjë me pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2008.

Objektivi primar i këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAP të shpreh opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të MTPT, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë dhe nëse regjistrat financiarë, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me Ligjet dhe rregulloret aplikative.

V. QASJA E AUDITIMIT

Auditimi ynë ishte planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 20/11/2008 deri 10/04/2009. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona, ne:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të MTPT-së në raport me buxhetin e aprovuar për vitin 2008;
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të MTPT-se janë përgatitur në pajtim me SNKSP-të “ Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
3. Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, procedurave analitike, rishikimin e dokumenteve dhe ekzaminimin fizik për të verifikuar dhe vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në MTPT, për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë;

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin, informatat dhe shpjegimet të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të MTPT-së, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit i cili

mund të jepet. Opinioni i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit (Cf. Aneksi 1 ISSAI 400).

VI. OPINIONI I AUDITIMIT

Për mendimin tonë, pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Si theksim i çështjeve ne dëshirojmë që t'iu tërhekim vëmendjen lidhur me:

Pasuritë fikse nuk janë shpalosur në pasqyra financiare.
(ISSAI 400 Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes).

VII. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KYÇE

1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Shpenzimet e përgjithshme aktuale për vitin 2008 ishin 126,852,449 €. Krahasuar me buxhetin për 2008 Ministria kishte shpenzuar rreth 91% të buxhetit të planifikuar dhe në fund të vitit 2008 kishte një suficit prej 12,541,636 €.

Obligimet e papaguara për vitin 2008 kanë qenë 45,787 €, të cilat kanë mbetur për t'u paguar për vitin 2009.

Të hyrat e mbledhura nga burimet vetjake për vitin 2008 ishin rreth 2,214,685 €. Në krahasim me vitin paraprak, ka rritje të hyrave prej 14.15%.

Konkluzioni

Në përqindje shkalla e shpenzimit të buxhetit vjetor duket mjaft e lart, prapëseprapë shuma e pashfrytëzuar prej më shumë se 12 milion euro flet për dobësi në menaxhimin e buxhetit. Menaxhmenti i MTPT duhet që krahas planifikimit më të mirë të nevojave buxhetore, të bëjë përpjekje që buxhetin ta shpenzojë maksimalisht në pajtim me projeksionet.

2. Pasqyrat Financiare

Pasqyrat financiare të vitit 2008 janë të sakta dhe të prezantuara drejt në aspektin material.

- Në pasqyra financiare nuk janë të paraqitura të gjitha pasuritë jo financiare në shënimet shpjeguese.

Konkluzioni

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në UA 2008/13 të MEF-it “Raportimi vjetor i organizatave buxhetore”, por nuk janë bërë shpalosjet e detajuara të shënimeve të pasqyrave financiare siç kërkohet me nenin 16 të këtij udhëzimi.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Ministrin e MTPT që të sigurojë:

Që Pasqyrat financiare të përgatiten në harmoni me UA 2008/13 të MEF-it “Raportimi vjetor i organizatave buxhetore” dhe shumat nga burimet e ndryshme të prezantohen në pozicione të veçanta ose të shpalosen dhe të sqarohen me informata më të zgjeruara.

Realizimi i Buxhetit

Vlera totale e të hyrave në MTPT për vitin 2008 ka qenë 2,214,685 € .

Gjatë auditimit tonë kemi ekzaminuar dhe marrë mostra nga:

- Të hyrat nga drejtoria e rrugëve (të hyrat nga kyçja në rrugë).
- Të hyrat nga patentë shoferi,
- Të hyrat nga transporti publik.

Gjetjet e auditimit mbi të hyrat nga kyçja në rrugë:

- Mos ndërmarrja e masave nga ana e MTPT për bizneset që janë kyçur ilegalisht në rrugë. Këto biznese nuk kanë bërë as kërkesë për marrjen e pëlqimit për kyçje në rrugë. Gjatë ekzaminimit të aksit rrugor Prishtinë –Ferizaj kemi vërejtur se prej 310 bizneseve, vetëm 30 prej tyre kanë pëlqimin për kyçje në rrugë. Mbrojtja e brezit rrugor parashihet me Ligjin nr. 2003/11-“Ligji për rrugët”(neni 28 dhe 31) dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 2004/1-“Mbi organin e inspektoratit” (neni 6).
- Arkëtimi i dobët i të hyrave nga bizneset që kanë marrë pëlqimin për kyçje në rrugë ka bërë që borxhet e papaguara prej vitit 2001 deri në fund të vitit 2008 të arrijnë shumën prej 2,144,124 €. Deri në fund të vitit 2008 janë paguar gjithsej 197,132 € ku shkalla e arkëtimit ishte 9.19 %. Edhe pse MTPT ka filluar të implementojë rekomandimin e vitit të kaluar sa i përket arkëtimit të borxheve të papaguara për kyçje në rrugë , duke iniciuar procedurat në gjykatë nga ana e zyrës ligjore të MTPT , borxhi i papaguar mbetet mjaft i lartë.

Konkluzioni

Mungesa e procedurave dhe udhëzimeve të brendshme nga ana e MTPT për ndërmarrjen e masave ndëshkuese ndaj këtyre bizneseve ilegale ka shkaktuar që MTPT dhe buxheti të humbin mjaft të hyra.

MTPT-ja nuk ka mekanizëm të mirë të ndërtuar të inkasimit me kohë e të hyrave.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Ministrin e MTPT që të sigurojë:

- Inicimin e procedurave dhe masa të parapara me ligj për pagesën e tarifave për kyçe në rrugë për të gjithë ata që ushtrojnë biznesin e tyre në mënyrë ilegale,
- Për shpejtimin e procesit të inicimit të procedurave në gjykatë në mënyrë që të rritet arkëtimi i të hyrave..

Mungesa e mbikëqyrjes në departamentin e automjeteve (Njësia e patentë shofereve) nga ana e MTPT

Ne kemi vërejtur se ka munges të kontrolleve gjatë testimit të kandidatëve për patent shofer gjat vitit 2008.

Konkluzioni

Nuk ekzistojnë kontrole adekuate mbi procesin e organizimit të provimeve për patent-shoferë. Kjo krijon mundësinë që të ndodhin aktivitete keqmenaxhuse të këtyre proceseve.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Ministrin e MTPT që të sigurojë:

- Të formohen komisione të rastësishme, të cilat do të kontrollojnë mbarëvajtjen e provimeve për patentë-shofer. Po ashtu, shkalla e monitorimit duhet të ngritet dhe të jetë objekt vlerësimi në baza të rregullta.

3 Shpenzimet permes procedurave te prokurimit

Në fushën e prokurimit kemi identifikuar disa raste ku procedurat e prokurimit, nuk janë në përputhje me kërkesat e LPP.

3.1 Prokurimi- rastet e ndryshme të mos pajtueshmërisë

Vlera totale e shpenzimeve për mallra e shërbime dhe investime kapitale për vitin 2008 në MTPT ka qenë 124,031,562 €. Ne kemi vërejtur një moster prej: 88,099,151 €, që përfshin rreth 70% nga totali i shpenzimeve.

Nga totali i të gjitha pagesave në MTPT për vitin 2008, investimet kapitale përfshijnë 90% prej tyre. Gjetjet e auditimit janë përshkruar si në rastet vijuese:

Mungesa e planit përfundimtar të prokurimit

Brenda 15 ditëve kalendarike pas shpalljes se legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë dhe do të dorëzojë APP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon të gjitha furnizimet , shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit fiskal.

Dhënia e kontratës operatorëve ekonomik edhe pse kanë qenë të papërgjegjshëm

- Tre operatorëve ekonomik i është dhënë kontrata edhe pse nuk i kanë përmbushur kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.
 1. Fituesi (OE) i kontratës me nr. 139/2008 me vlerë të kontratës prej 2,074,077 € nuk e ka pasur raportin e auditorit për vitin 2005.
 2. Fituesi (OE) i kontratës me nr. 0071/08 me vlerë të kontratës prej 1,839,437 € nuk i ka pasur raportet e auditorit për tre vitet: 2005, 2006 dhe 2007.
 3. Fituesi (OE) i kontratës me nr. 150/2008-“Jehona” me vlerë të kontratës prej 4,499,219 € nuk e ka pasur raportin e auditorit për vitin 2007.
- Fituesi (OE) i kontratës me nr. 0071/08 me vlerë të kontratës prej 1,839,437 euro nuk e ka pasur vërtetimin e ATK të vendit të themelimit të OE (përshtatshmëria ligjore).

Vlerësimi jo i duhur i ofertave gjatë përzgjedhjes së operatorëve ekonomik

- Në lëndën me nr. të kontratës 113/2008-“Zgjerimi i rrugës M9, (Prishtinë-Pejë) segmenti Udhëkryqi Fushë-Kosovë-Sllatinë e madhe: Lot-1” me vlerë të kontratës 5,989,983 €. Fituesi i kontratës është shpallur kompania me çmim më të lartë se dy konkurrentët tjerë më të lirë për Lotin 1. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë fazë ose element të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që diskriminon në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik.
- Gjatë vlerësimit të ofertuesve tek lënda me nr. të prokurimit 08/097/511:”Zgjerimi i rrugës M2, pjesa Çagllavicë-M2/M25 (QMI), faza e II-Lot I” dhe “Zgjerimi i rrugës M2, pjesa Çagllavicë-M2/M25 (QMI), faza e II-Lot II” , kemi poentim të ndryshëm për ofertuesin e njëjtë.
- Tek lënda: ”Ndërtimi i rrugës Arllat-Malishevë-Rahovec-Xërxe” me nr. të prokurimit 08/143/551 dhe nr. të kontratës 150/2008, vlera e kontratës 4,499,219 €. Gjatë vlerësimit të ofertave fituesi merr maksimumin e pikëve të poentimit tek kriteri teknik.
- Lënda: ”Sanimi i urës në rrugën M9 Gjakovë-Morinë” me nr. të kontratës:092/08 dhe vlera e kontratës prej 220,237 € është përzgjedhur fitues me nr maksimal të poenave edhe pse kjo nuk mbështetet me dokumente.

Konkluzioni

MTPT ka kontrollë të brendshme joadekuate mbi procesin e saj të prokurimit duke e rritur kështu rrezikun e humbjeve dhe keqpërdorimeve.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Ministrin e MTPT që të sigurojë:

- Që MTPT ti përmbahet të gjitha kërkesave administrative të prokurimit, pra edhe përgatitjen dhe dorëzimin e planit përfundimtar të prokurimit.

- Që MTPT të zhvillojë një proces adekuat të vlerësimit preliminar në përputhje me kërkesat e përshtatshmërisë ligjore, ekonomike dhe financiare në përzgjedhjen e ofertuesve. Të rishikojë procesin aktual të vlerësimit të tenderit dhe të sigurojë që procesi i përmbahet kritereve të publikuara të vlerësimit dhe të jetë në pajtim me ligjin e prokurimit

4.Paraja e imët

Në disa raste të shpenzimeve me para të imta (dhurata për punëtorë, për larje të veturave, për blerjen e materialit higjieno-sanitar, blerjen e materialit për mirëmbajtje dhe riparim të veturave) janë bërë pagesa për shpenzimet për të cilat ka ekzistuar kontrata.

Konkluzioni

MTPT-ja nuk i ka vendosur kontrollet adekuate për sa i përket parasë së gatshme.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Ministrin e MTPT që të sigurojë:

MTPT duhet të sigurojë pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Udhëzimit Administrativ, Rregullat financiare dhe udhëzimit të Thesarit 02- Shpenzimet e parasë publike.

5. Menaxhimi i Pasurisë

Të gjeturat

- Është blerë programi për regjistrimin e pasurisë, dhënat nuk janë futur në program.
- Nuk është përfshirë e gjithë pasuria kapitale dhe jo kapitale mbi 1,000 € në regjistrin kontabël në vlerë prej 5,284,810 €, për shkak të kryerjes së pagesave edhe pas mbylljes së vitit fiskal.
- Moskryerja e procesit të inventarizimit në mënyrë të plotë në pajtim me UA 2005/11- Menaxhimi dhe regjistrimi i pasurive qeveritare.
- Nuk është harmonizimi i plotë në mes të rixhistrir kontabël dhe gjendes faktike të pasurisë në ministri.

Konkluzion

Menaxhimi me pasurinë kapitale dhe jokapitale nuk është në përputhje me standartet. Mos regjistrimi, mos inventarizimi i duhur dhe mos azhurnimi i të dhënave i të gjitha pasurive e komplikon planifikimin e investimeve dhe kryerjen e aktiviteteve në mënyr më të efektshme.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Ministrin e MTPT që të sigurojë:

Që MTPT të ketë një sistem të përbashkët për regjistrimin e pasurive , i cili mund të ndërlihet me modulën e kontabilitetit. Kjo do të sigurojë që të gjitha pasuritë e blera dhe të gjitha lëvizjet janë regjistruar plotësisht dhe saktësisht në regjistrin e pasurive fikse .

Investimet kapitale (ndërtimet e rrugëve, urave etj.) që kanë ndodhur gjatë vitit 2008 të regjistrohen në regjistrin kontabël të pasurisë.

6. Sistemet e Kontrollit të brendshëm dhe auditimi i brendshëm

Nga vlerësimet tona në kapitujt e sipër përmendur mund të kuptohet qartë se sistemi i kontrollit të brendshëm brenda ministrisë nuk aplikohet në nivelin e pritur dhe si i tillë ka nevojë të rishikohet dhe përmirësohet. Për pasojë, kontrollet e brendshme të vendosura brenda MTPT-së për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve, parregullsive dhe mashtrimeve potenciale nuk kanë funksionuar si duhet dhe në këtë mënyrë nuk janë arritur objektivat e pritura.

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur këshillëdhënëse e cila ofron siguri të arsyeshme, e dizajnuar që të përmirësojë dhe të shtojë dobinë e funksionimit të një organizate. I ndihmon organizatës në përmbushjen e objektivave duke ofruar qasje sistematike dhe të disiplinuar mbi vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve.

Të gjeturat

- Ne i kemi intervistuar auditorët e brendshëm dhe i kemi rishikuar raportet e tyre. Për shkak të numrit të limituar të auditorëve, në fushëveprimin e tyre nuk janë përfshirë sferat me rrezik të lartë për auditim, siç është rasti me sektorin e prokurimit, ku 90% e buxhetit të MTPT-së i përket kësaj sfere.

Konkluzion

Në fushën e prokurimeve, menaxhimit të pasurive, MTPT nuk ka vendosur kontrolle adekuate.

Kontrollet e dobëta rrisin rreziqet e llojeve të ndryshme të keqpërdorimeve dhe mashtrimeve.

Auditimi i brendshëm nuk ka përmbush mjaftueshëm funksionin e tij. Fushat e identifikuara me rrezik të lartë duhet të jenë prioritet i Njesisë së auditimit të brendshëm në aktivitetet e ardhme.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Ministrin e MTPT që të sigurojë:

Krahas zbatimit të rekomandimeve të dhëna më lartë, të cilat janë rezultat i dobësive në sistemin e kontrolleve të brendshme, të cilat do të ndihmonin në përmirësimin e performancës së MTPT-së, Menaxhmenti duhet të ndër marr edhe masat vijuese:

- Që NJAB-i t'i planifikojë dhe kryej aktivitetet e saja vjetore edhe për vitin (periudhën) aktuale në bazë të metodologjisë së bazuar në vlerësimin e rrezikut.

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009 (e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionit. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) ka patur limite në fushëveprimin e auditimit
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat,

atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Komentet e MTPT-së dhe Vlerësimet e ZAP-it

Komentet e Ministrisë	Vlerësimet e ZAP
<p>Komenti nr. 1.1</p> <p>Plani i prokurimit publik përfundimtar nuk është dorëzuar për shkak të afateve të shkurta kohore, gjegjësisht periudhës kohore derisa është konsoliduar Qeverisja e re pasi është marre mandati ministror dhe definimi dhe përcaktimi i prioriteteve dhe projekteve kapitale për një periudhë kohore modeste.</p>	<p>Rekomandimi nr. 1.1</p> <p>Ministria duhet të ruaj kontinuitetin e veprimit, pavarësisht ndërrimit të menaxhmentit si dhe t'i përmbush obligimet ligjore.</p> <p>Konkluzionet e auditimit mbeten të pandryshuara.</p>
<p>Komenti nr. 1.2</p> <p>Ministria e Transportit dhe Poste-Telekomunikacionit, respektivisht komisionet vlerësuese, të ngarkuara për vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, në mungesë të operatoreve ekonomik plotësisht të përgjegjshëm, kanë vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 63.1 të Ligjit Mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i cili thekson: "Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.</p>	<p>Rekomandimi nr. 1.2</p> <p>Mbetet e gjetura dhe konkluzioni i ZAP-it.</p> <p>Kur gjatë vlerësimit të ofertave kriteri (në rastin konkret ekonomik-financiar) kërkohej me dosje të tenderit , kur dihet se dosja e tenderit është obligative sipas LPP, atëherë tenderuesit e papërgjegjshëm duhet eliminuar.</p> <p>Rekomandimet përkatëse do të jenë pjesë e raportit.</p>
<p>Komenti nr. 1.3</p> <p>Në lëndën me nr. të kontratës 113/2008, operatori ekonomik i shpërblyer me kontratë ka pasur vetëm një Operator ekonomik më të lirë, mirëpo ofertuesi më i lirë ka qene në lotin 3 diferenca në çmim ndërmjet Operatorit të shpërblyer me kontratë në lotin 1 dhe Operatorit ekonomik të shpërblyer me kontratë në lotin 3 ka qenë evidente.</p>	<p>Rekomandimi nr. 1.3</p> <p>E gjetura jonë ka të bëjë me lotin 1, ku ka pasur dy ofertues me çmim më të lirë. Prandaj, gjetjet dhe konkluzionet e auditimit mbesin të pa ndryshuara.</p>

<p>Komenti nr. 2</p> <p>Rekomandimi, konkluzioni dhe gjetjet e pjesës së katër (4) janë të bazuar në shpenzimet e vërteta që kanë ndodhur nga zyrtaret e MTPT-se por nuk qëndron konstatimi që për të njëjtat shpenzime kanë ekzistuar kontrata në vendet ku kanë ndodhur këto shpenzime si dhe në lidhje me procedurat e parasë së imët dhe në pajtim me rregulloren në fuqi ka raste kur mundësitë rrethore nuk lejojnë iniciimin e procedurës për kryerjen e punës dhe shërbimit.</p>	<p>Rekomandimi nr. 2</p> <p>Pika 9.3 –“ Rregullat Financiare 02-Shpenzimi i parave publike” i shpjegon kushtet nën të cilat mund të përdoret paraja e imët.</p> <p>Në kemi konstatuar rastet si p.sh.: për larje të veturave, për blerjen e materialit higjieno-sanitar, blerjen e materialit për mirëmbajtje dhe riparim të veturave janë bërë pagesa për shpenzimet për të cilat ka ekzistuar kontrata.</p> <p>Mbetet e gjetura dhe konkluzioni i ZAP.</p>
<p>Komenti nr. 3.1</p> <p>Është e vërtetë që të dhënat nuk janë të futura në softuerin e ri për menaxhimin e pasurive por të gjitha pasuritë janë të futura dhe evidentuara në programin e vjetër me çka është raportuar te ZAJ, çka do të thotë që për institucionet publike nuk ka standardizim të softuerëve me përjashtim të Free Balancit dhe se të gjithë institucionet publike janë të lirë të përdorin programe të ndryshme, por zyrtar dhe i vetmi i besueshëm është Free Balanci.</p>	<p>Rekomandimi nr. 3.1</p> <p>MTPT-ja pajtohet me gjetjet tona dhe konkluzionin e auditimit.</p>
<p>Komenti nr. 3.2</p> <p>Nëse krahasohen Investimet kapitale me pasuritë ekziston diferenca e cila është cekur në këtë draft raport, por, bazuar në udhëzimin për menaxhimin e pasurisë 2005/11 pasuria evidentohet në evidencat e thesarit vetëm atëherë kur në mënyrë të fortë faktike evidentohet kryerja e pagesës për një shpenzim kapital apo blerje të pasurisë në mes 1,000.00 dhe 5,000.00 euro . Andaj të nderuar një pjesë e këtyre lëndëve (brenda shumës së lartë cekur) për shpenzimeve kapitale dhe pajisje (1,000.00 deri 5,000.00 €) janë proceduar deri në kohën e fundit për pagesë në thesar - MFE e që të njëjtat nuk janë kthyer dhe nuk kanë mundur të regjistrohen në evidencat e modulit të pasurisë deri pas përfundimit të vitit për arsye të vëllimit të madh të lëndëve të shumta nga të gjitha Organizatat Buxhetore të Kosovës</p>	<p>Rekomandimi nr. 3.2</p> <p>MTPT shpjegon arsyet se pse nuk janë regjistruar të gjitha pasuritë fikse. Kjo nuk ofron bazë për ndryshimin e gjetjeve të auditimit. Konkluzionet e auditimit mbeten të pa ndryshuara në raport.</p>

proceduar në Thesar - MEF.	
<p>Komenti nr. 3.3</p> <p>Bazuar në të dhënat tona dhe të dhënat e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa pasuritë jo financiare (110 automjetet të cekura në këtë pikë të këtij draft raporti) janë të evidentuar në raportin tim dhe në atë të thesarit në vitin 2006.</p>	<p>Rekomandimi nr. 3.3</p> <p>Pas pranimit të dëshmive shtesë, ZAP ka pranuar komentin si të bazuar dhe do të bëj korrigjimin e raportit për sa i takon kësaj pjese.</p>
<p>Komenti nr. 4</p> <p>Njësia e auditimit të brendshëm jep këtë sqarim lidhur me pikën 6 Kontrolli i brendshëm pjesa të gjeturat ku thuhet se auditimi i brendshëm nuk ka bërë asnjë auditim në vitin 2008 në departamentin e prokurimit me theks të veçante investimet kapitale. Njësia e auditimit të brendshëm duke u bazuar në Ligjin për Auditim të Brendshëm nr. 02/L-74 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/19, doracakët dhe format standarde për auditim të brendshëm të hartuara nga NJQH e Ministrisë së Financave të bazuara në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm ka hartuar planin operativ vjetor për vitin 2008 plan I cili edhe është zbatuar në vitin 2008 në tërësi.</p> <p>Në këtë plan operativ kopjen e të cilit iu është dorëzuar auditorëve të ZAGJ të cilët kanë bërë këtë auditim në MTPT, ka qenë e përfshirë edhe auditimi në departamentin e prokurimit gjegjësisht investimet kapitale me emër të auditimit: Prokurimi, investimet kapitale, auditimi i cili është kryer në periudhën Janar-Mars 2008 i përkrahur edhe nga ekspertët e Human dynamics si pjesë e trajnimit të auditorëve të brendshëm të organizuar nga ministria e financave.</p> <p>Kopja e këtij raporti final iu është dorëzuar auditorëve tuaj, pastaj për shpenzime kapitale me planin operativ të lartcekur kemi pasë edhe auditimin në zyrën e financave me emër të auditimit: Shpenzimet kapitale, mallra dhe shërbime, paga dhe mëditje dhe shërbimet komunale, kopja e të cilit raport final iu është dorëzuar juve I kryer në periudhën Mars-Prill të vitit 2008.</p>	<p>Rekomandimi nr. 4</p> <p>Gjate intervistës me auditorin e brendshëm dhe rishikimit të raporteve të auditorëve të brendshëm nga ana e auditorëve të ZAP kemi verifikuar se nuk është kryer asnjë auditim në prokurim në MTPT gjatë vitit 2008..</p> <p>Rekomandimet përkatëse do të jenë pjesë e raportit.</p>